

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika® SealTape S

SHIRIT I POSAÇËM PËR HIDROIZOLIM PËRRETH PERIMETRIT DHE FUGAVE NË ZONA ME PLLAKA TË LAGËSHTA

### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® SealTape S është një shirit hidroizolues me rrjetë lidhëse të thurur në secilën anë dhe një zonë elastike përhapjeje në mes. Produkti përdoret si përbërës i një sistemi të përbërë izolimi në ndërthurje me membranën hidroizoluese, kollën e pllakave dhe pllakave qeramike për të arritur papërshkueshmëri nga uji në banjo dhe zonat përreth banjove.

### PËRDORIMET

- Izolim i perimetrit poshtë pllakave në banjo (banjo private dhe publike dhe kuzhina) dhe në tarraca dhe ballkone
- Izolim i fugave vertikale dhe horizontale të lëvizjes në fugat e izolimit, lidhjes dhe ndërtimit në cepa dhe përreth hyrjeve të tubave
- Për përdorim të jashtëm e të brendshëm

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Elasticitet i lartë
- Hidroizolues
- Rezistencë kimike
- Instalim i lehtë
- Rezistenca termike: -25°C deri në +60°C

### MIRATIME / STANDARDE

'Shoqata Europiane e shtrimit të pllakave me rezistencë ndaj acideve - Institut Testimi & Konsulencë për mure dhe dysheme'.  
Certifikatë testimi për papërshkueshmëri nga uji : Cert. Nr. 60210601.001.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Shiriti: elastomer termoplastik Përforcimi: pëlhurë e thurur poliesteri
<b>Ambalazhi</b>	Gjatësi ruloni: 10 dhe 50m, 1 rulon/ kuti kartoni Pjesë të paramodifikuara: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kënde të brendshme 90°: IC, 10 copë për pako / 5 pako për kuti</li> <li>▪ Kënde të jashtme 270°: OC, 10 copë për pako / 5 pako për kuti</li> <li>▪ Pjesë të paramodifikuara për mure 120 x 120 mm: WF, 2 copë për pako / 70 pako për kuti</li> <li>▪ Pjesë të paramodifikuara për dysheme 300 x 300 mm: FF, 2 copë për karton / 20 kartona për kuti</li> </ul>
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Ngjyra: e verdhë
<b>Trashësia</b>	0,6 mm
<b>Gjerësia</b>	120 mm
<b>Gjatësia</b>	10 ose 50 m
<b>Jetëgjatësia</b>	36 muaj

## Kushtet e magazinimit

Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar dhe në kutinë origjinale të kartonit në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +40°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.

## TË DHËNA TEKNIKE

Zgjatimi	Tërthor: 300%
Rezistenca ndaj grisjes	Tërthore: > 2.0 MPa
Palosja në temperatura të ulëta	Pa plasaritje në -20°C
Papërshkueshmëria e ujit	3 bar (DIN1048/5)
Rezistenca kimike	Rezistues ndaj ujit të kripur (20g/L), acidit citrik (100g/L), acidit klorhidrik (3%) acidit sulfurik (35%). Për më tepër informacione ju lutemi kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik Sika.
Vjetrimi termik	-25°C deri në +60°C. Në kushte të thata dhe të lagështa.
Transmetimi i avujve të ujit	1.5 bar (DIN EN 1928 versioni B)

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Produkte ndihmëse për ndërkapjen: <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Sikalastic®-150: Ilaç me 2 përbërës, elastik dhe i përforcuar me fibra për hidroizolim</li><li>▪ SikaTop® Seal-107: Ilaç i hollë çimentoje për hidroizolim</li></ul> Për produkte të tjera të ngjashme Sika® që mund të jenë të përshtatshme për përdorim me Sika® SealTape S ju lutemi kontaktoni me departamentin tuaj lokal të shërbimit teknik.
----------------------	---

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e thatë, e pastër dhe pa vaj, graso apo kontaminues të tjerë, kore çimentoje dhe grimca të lira ose të shkrifëta.

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nëse nevojitet duhet përdorur një material/sistem i përshtatshëm prajmeri (ju lutemi referohuni tek skedat teknike të Sikalastic®-150 dhe SikaTop® Seal-107).

### METODA E APLIKIMIT / MJETET

1. Aplikoni Ilaçin e përzierë Sika® për izolim dhe shtrim (p.sh. Sikalastic®-150 ose SikaTop® Seal-107) në të dy anët e fugës/ skajeve, duke lënë ~ 10 mm në të dy anët e skajit pa Ilaç.
2. Vendosni Sika® SealTape-S mbi fugën/ skajin e veshur me Ilaç dhe ngjeshni fort shiritin tek Ilaçi.
3. Mbuloni plotësisht shiritin me Ilaçin hidroizolues (Sikalastic®-150 ose SikaTop® Seal-107).
4. Pastaj vazhdoni shtrimin e pllakave me aplikim normal të kollës së pllakave etj. Ju lutemi referohuni tek skeda teknike përkatëse e kollës së pllakave Sika.

### Fugat e shiritave:

Shiritat mund të ngjiten bashkë me izoluesin-adeziv SikaBond® AT Universal. Mbivendosjet duhet të jenë të paktën 40 mm. Më pas mbulonit të gjithë fugën e shiritit me Ilaçin hidroizolues Sika®.

Për izolim përreth shiritave, tubave të furnizimit me ujë apo tubave të tjerë dhe në qoshe përdorni profilet e posaçme për qoshet Sika SealTape (kënde të brendshme e të jashtme dhe unaza për tuba).

### KUFIZIME

Sika® SealTape S nuk është i përshtatshëm për pishinat. Për këtë përdorim, ju lutemi përdorni Sika® SealTape F.

Ju lutemi kontaktoni me departamentin lokal të shërbimit teknik për informacione të mëtejshme.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositetë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® SealTape S

Prill 2019, Botimi 01.01

020404100100000011

SikaSealTapeS-sq-AL-(04-2019)-1-1.pdf